

## **GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË**

KA 278/10, P 309/10

KA 309/10, P 340/10

Data: 2 Mars 2011

Gjyqtari i EULEX-it, Vitor Hugo Pardal, në cilësinë e gjykatësit për konfirmim të aktakuzës të ushtruar në këtë gjykatë në lëndën penale me numrin e shënuar më lart kundër

**Lufti DERVISHI**, i biri i Hamit dhe Elfije Mehatit, doktor urolog dhe asistent profesor, doktoraturë në mjekësi, i lindur më 6 Prill 55 në fshatin Gradice, Gllogovc, shqiptar i Kosovës, numri i letërnjoftimit 1004105717, i martuar, me dy fëmijë, dhe me vendbanim në Prishtinë,

**Arben DERVISHI**, i biri i Lufti dhe Vjlloca Syliqit, ekonomist, vazhdon studimet e nivelit Master, dega ekonomi, i lindur më 3 Dhjetor 83 në Prishtinë, shqiptar i Kosovës, numri i letërnjoftimit 03271061, i martuar, me një fëmijë dhe me vendbanim në Prishtinë,

**Driton JILTA**, i biri i Ibrahim dhe Arife Kurtit, doktor kirurg, i lindur më 21 Gusht 62 në Prishtinë, turk i Kosovës, numri i letërnjoftimit 02494253, i martuar, me dy fëmijë dhe me vendbanim në Prishtinë,

**Ilir RRECAJ**, i biri i Nezir dhe Hava Avdijajt, doktor, Master në mjekësi, i lindur më 14 Prill 63 në fshatin Llaushë, Skenderaj, shqiptar i Kosovës, numri i letërnjoftimit 02571105, i martuar, me dy fëmijë dhe me vendbanim në Prishtinë,

**Sokol HAJDINI**, i biri i Ragip dhe Stanica Stojiljkoviç, doktor, specialist në anesteziologji dhe reanimacion, i lindur më 3 Nëntor 54 në Prishtinë, shqiptar i Kosovës, numri i letërnjoftimit 02430359, i martuar, me tre fëmijë dhe me vendbanim në Prishtinë;

**Islam BYTYQI**, i biri i Ilaz dhe Remzije Abdullahut, doktor, specialist në anesteziologji dhe përkujdesje intenzive, i lindur më 17 Prill 70 në Qylage, Lipjan, shqiptar i Kosovës, numri i letërnjoftimit 025656368, i martuar, me katër fëmijë dhe me vendbanim në Prishtinë,

**Suleiman DULLA**, pseudonimi Syle, i biri i Bajram dhe Hana Matoshit, doktor, specialist në anesteziologji dhe përkujdesje intenzive, i lindur më 14 Qershor 65 në fshatin Magure, Lipjan, shqiptar i Kosovës, numri i letërnjoftimit 02537828, i martuar, me tre fëmijë dhe me vendbanim në Prishtinë,

Të ngarkuar me aktakuzën PPS Nr. 41/09 të ushtruar më 15 Tetor 2010 dhe me aktakuzën PPS Nr. 107/10 të ushtruar më 20 Tetor 2010, që të dyja nga Prokurori Publik Special Z. Jonathan Ratel me akuzat si në vijim:

Pika 1 – trafikim me njerëz, KPK 139.1 dhe 23 – të pandehurit: LUFTI DERVISHI, ARBAN DERVISHI, DRITON JILTA dhe SOKOL HAJDINI

Pika 2 – Krim i organizuar, KPK 274.3 dhe 23 - të pandehurit: LUFTI DERVISHI

Pika 3 - Krim i organizuar, ÇK 274.1 - të pandehurit: ARBEN DERVISHI, DRITON JILTA dhe SOKOL HAJDINI

Pika 4 – ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, KPK 221.1 dhe 23 - të pandehurit: LUFTI DERVISHI, DRITON JILTA dhe SOKOL HAJDINI;

Pika 5 – shpërdorim i pozitës zyrtare, KPK 339.3 - të pandehurit: DRITON JILTA dhe ILIR RRECAJ

Pika 6 (bashkuar) - ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore, KPK 221.1 dhe 23 - të pandehurit: ISLAM BYTYQI and SULEJMAN DULLA;

#### **Për shkak se**

Pika 1: Në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 2008, Lufti DERVISH, Driton JILTA dhe Sokol HAJDINI kanë kryer veprën penale trafikim me njerëz duke marrë pjesë në heqjen e organeve të tyre për t'i transplantuar tek personat e tjerë për qëllim shfrytëzimi në apo afër Prishtinës, Kosovë dhe në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 2008, Arben DERVISHI ka kryer veprën penale trafikim me njerëz duke dhënë kontribut esencial në kryerjen e veprës penale, përfshirë rekrutimin, transportin, strehimin apo pranimin e personave me qëllim të shfrytëzimit të tyre në apo afër Prishtinës, Kosovë.

Pika 2: Në mes të datës 1 janar 2006 dhe 4 nëntor 2008, Lufti DERVISHI organizoi, themeloi, mbikqyri, menajtoi apo udhëhoqi aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal së bashku me Yusuf SONMEZ dhe Moshe HAREL, bashkëpunëtorë ndaj të cilëve nuk është ngritur akuza, në apo afër Prishtinës, Kosovë.

Pika 3: Në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 2008, Arben DERVISHI, Driton JILTA dhe Sokol HAJDINI kanë kryer veprën penale krim të organizuar duke kryer vepra të rënda penale, përfshirë trafikimin me njerëz brenda një grupi të strukturuar me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt apo të tërthort financiar në apo afër Prishtinës, Kosovë.

Pika 4: Në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 2008, Lufti DEVISHI, Driton JILTA dhe Sokol HAJDINI kanë kryer veprën penale të dhënies së trajtimit mjekësor apo kyqjes në aktivitete mjekësore për të cilat kërkohen kualifikime specifike me ligj pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizimet ligjore në apo afër Prishtinës, Kosovë.

Pika 5: Në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 4 2008, Driton JILTA ka kryer veprën penale të shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autoritetit duke tejkualuar kufinjt e autorizimit të tij apo duke mos zbatuar detyrat e tij zyrtare si mjek për Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), gjë që solli deri te përfitimi material në shumën mbi 5000 Euro në apo afër Prishtinës, Kosovë dhe në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 2008, Ilir RRECAJ ka kryer veprën penale shpërdorim të pozitës zyrtare duke tejkualuar kufinjt e autorizimit të tij apo duke mos zbatuar detyrat e tij zyrtare si ish-Sekretar i Përhershëm i Ministrisë së Shëndetësisë në Republikën e Kosovës, gjë që solli deri te përfitimi material në shumën mbi 5000 Euro në apo afër Prishtinës, Kosovë.

Pika 6 (e bashkuar): Në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 2008, Islam BYTYQI dhe Sulejman DULLA kanë kryer veprën penale të dhënies së trajtimit mjekësor apo kyqjes në aktivitete mjekësore për të cilat kërkohen kualifikime specifike me ligj pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizimet ligjore në apo afër Prishtinës në bashkë-kryerje me Lufti DERVISHI, Driton JILTA dhe Sokol HAJDINI.

Pas seancave për konfirmim të mbajtura më 14 dhjetor 2010 dhe 6 janar 2011 në praninë e të gjithë të pandehurve, avokatëve të tyre mbrojtës si dhe prokurorit publik special Jonathan Ratel (përfaqësuesit e palëve të dëmtuara nuk ishin të pranishëm gjatë seancave),

Një vendim i veçant mbi pranueshmërinë e provave është nxjerrë më 31 janar 2011, vendimi është sfiduar dhe është anuluar me anë të vendimit mbi ankimim, datuar 1 mars 2011 të nxjerrë nga trupi gjykues kompetent i përbërë nga tre gjykatës.

Në pajtim me nenin 316, paragrafi 1 deri 4, KPPK dhe siç u udhëzua me vendimin e lartpërmendur, nxjerrë si në vijim

### AKTVENDIM

1. Aktakuza PPS. 41/09 e ngritur më 15 tetor 2010 përmban informatat dhe përmbushë kërkesat e parapara me nenin 305, paragrafi 1, nënparagrafët 1 deri 7, KPPK.
2. Prokuroria Publike ka përmbushur obligimin lidhur me zbulimin e provave, siç parashihet me nenet 307 dhe 308, KPPK.
3. Të gjitha provat në dosjen e gjykatës dhe të cilave u referohet në dokumente që janë dorëzuar në gjykatë konsiderohet të pranueshme nga Trupi Ankimor dhe u vlerësuan sipas udhëzimit.
4. AKTAKUZA PPS. 41/09, e ushtruar më 15 tetor 2010, KONFIRMOHET në pikat në vijim sa u përket të pandehurve në vijim:
  - Pika 4 lidhur me të pandehurit LUFTI DERVISHI, DRITON JILTA dhe SOKOL HAJDINI;
  - Pika 5 lidhur me të pandehurin ILIR RRECAJ.
5. AKTAKUZA PPS. 41/09, e ushtruar më 15 tetor 2010, HEDHET POSHTË në pikat si në vijim dhe PROCEDURA PENALE PUSHON sa u përket të pandehurve në vijim:
  - Pika 1 lidhur me të pandehurit LUFTI DERVISHI, ARBAN DERVISHI, DRITON JILTA dhe SOKOL HAJDINI;
  - Pika 2 lidhur me të pandehurin LUFTI DERVISHI;
  - Pika 3 lidhur me të pandehurit: ARBEN DERVISHI, DRITON JILTA dhe SOKOL HAJDINI;
  - Pika 5 lidhur me të pandehurin DRITON JILTA;
6. AKTAKUZA PPS. 107/10 e ushtruar më 20 tetor 2010 KTHEHET në prokurori për të pësuar ndryshime, me përshkrim të saktë të fakteve brenda tre ditëve sipas udhëzimeve të parapara me nenet 305, paragrafi 4, KPPK, sa i përket nenit 306, paragrafi 2, KPPK, e zbatueshme në mënyrë analoge.
7. Pasi që aktakuza PPS. 41/09, e ushtruar më 15 tetor 2010 bëhet e plotfuqishme, ajo dhe dosja e lëndës menjëherë dërgohet te Kryetari i Trupit Gjykues për shqyrtim kryesor, i cili do të vendosë lidhur me ndonjë ndarje të procedurës.

8. Vendimi mbi gjësendet e konfiskuara dhe ndërtesave të mbyllura do të merret pasi që ky vendim të bëhet i plotfuqishëm.

## ARSYETIMI

### 1. Kompetenca e gjykatës

Juridiksioni dhe kompetenca për të kryer procedurën e përmendur më lart i është dhënë gjykatësit të nënshkruar me emërimin specifik të ZKGJE-së nëpërmjet vendimit të nxjerrë më 27 nëntor 2010. Kjo lëndë është kompetencë ekskluzive e gjykatësve nga EULEX në pajtim me nenin 5, paragrafi 1 të Ligjit 03/L-052 dhe nenit 3, paragrafi 1 të Ligjit 03/L-53.

### 2. Konstatimet e gjykatës

#### a. Konstatimet paraprake procedurale

Gjatë seancës për konfirmim, disa nga avokatët mbrojtës (Bajram Tmava, Mexhid Sylja, Aqif Tuhina dhe Fazli Balaj) ngritën çështjen e shkëljes eventuale të nenit 305, paragrafi 1, KPPK. Sipas tyre, aktakuza e ushtruar kundër klientëve të tyre nuk përkon me kërkesat e procedurës të parapara me nenin dhe paragrafin e përmendur, veçanërisht “çështja “*në Prishtinë apo afër Prishtinës*” u ngrit si përshkrim i mjaftueshëm/i pamjaftueshëm i vendit ku pretendohen të jenë kryer veprat penale. Çështja “*në mes të datës 1 janar dhe 4 nëntor 2008*” gjithashtu u ngrit si përshkrim temporal i mjaftueshëm/pamjaftueshëm i fakteve të pretenduara, përshkrimi i pamjaftueshëm i *asaj* që është bërë dhe *si* është bërë (mënyra) dhe elemente dhe rrethana të tjera faktike që ligjërisht kërkohen për të përshkruar këto vepra specifike penale (p.sh. cilat vepra penale të rënda, cili kërcënim, baza faktike për kontroll të nevojshëm mbi personin tjetër, etj.)

Siç parashihet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 305, paragrafi 1, KPPK, “*aktakuza përmban:*

- 1) *Emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale (neni 245 i këtij Kodi);*

- 2) Të dhënat nëse është shqiptuar paraburgimi dhe sa kohë ka zgjatur ose masat e urdhëruara nga kapitulli XXX i këtij Kodi kundër të pandehurit, nëse ai ndodhet në liri dhe nëse ai është liruar para ngritjes së aktakuzës, sa është mbajtur nëparaburgim;
- 3) Emërtimin ligjor të veprës penale duke i'u referuar dispozitave të Kodit të Përkohshëm Penal;
- 4) Koha dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale;
- 5) Shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore;
- 6) Përcaktimin e gjykatës ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe
- 7) Rekomandimin për provat që duhet prezentuar në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhet lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë.

Siç mund të shihet qartë, neni i cekur më lart nuk ofron listë të kufizuar të të gjitha elementeve faktike që duhen zgjedhur në mënyrë specifike dhe të strukturuar. Sa u përket çështjeve që kundërshtohen – nënparagrafi 4 – i vetmi kriter ligjor duhet të jetë: aktakuza duhet të përmbajë kushtet e vlerësuara si “të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale”, edhe pse përmendet koha dhe vendi në veçanti. Askund nuk përmendet nëse këto rrethana duhet të jenë pjesë e një kapitulli të caktuar të quajtur “akuzat”, “s qarimi”, “përshkrimi” apo çkado. Edhe pse është e kuptueshme se logjika e aktakuzave të strukturuar mund të jetë më e njohur për disa nga palët, sipas të ashtu-quajturit “sistem kontinental”, KPPK-ja nuk i mbyllë derën një strukture “ligji të përbashkët”. I vetmi kusht ligjor që duhet përmbushur është ai vijues: e gjithë aktakuza duhet të rezultojë në përcaktimin e saktë të veprës penale.

Rëndësia e vendit dhe kohës si rrethana tejet të rëndësishme në përshkrimin e saktë të fakteve nuk vihet në pyetje. Për më tepër, në shumicën e veprave penale, këto dhe disa rrethana të tjera janë thelbësore në përcaktimin e vet veprës penale.

Mirëpo, studimi i aktakuzës PPS Nr. 41/09 si tërësi na bën të kuptojmë se nuk ekziston asnjë fakt i vetëm që mund të sjellë deri te dyshimi që të gjitha faktet përshkruhen mjaftueshëm, kanë datën dhe vendin, madje të specifikuar edhe brenda një gridi, lidhur me secilin të pandehur, secilën nga veprimet, nën kapitullin “II. Arsyetimin” e më tutje. Niveli i saktësisë është i kuptueshëm dhe në veçanti, nuk ekziston asnjë fakt (kyq) që sjellë deri te keqkuptimi apo te ndonjë vështirësi tjetër që eventualisht mund të shmangë mbrojtjen efikase nga cilado pikë e akuzës nga ana e cilitdo të akuzuar. Jo vetëm pikat e akuzës, por e gjithë aktakuza si tërësi duhet të konsiderohet ligjërisht, dhe prandaj, gjykatësi i nënshkruar është i mendimit se kjo aktakuzë përmbushë të gjitha kushtet e parapara me nenin 305, paragrafi 1, nënparagrafët 1 deri në 7, KPPK.

Lidhur me aktakuzën PPS Nr. 107/10, edhe pse çështje e mëparshme, do të analizohet më poshtë së bashku me të ashtuquajturën Pikë 6.

#### b. Korniza faktike dhe ligjore

Që të gjitha pikat e akuzës do të analizohen më poshtë brenda kornizës ligjore në vijim.

*1. Lidhur me pikët 1 gjer 3:*

Siç edhe dokumentohet në dosje të lëndës, provat në vijim u konsideruan relevante për këto pika:

- Raporti i vëzhgimit – Dosja V, faqe 56
- Lista e telefonatave të regjistruara – Dosja V, faqe 59 deri 61, 63 to 65, 69, 70 dhe 76
- Raportet e policisë– Dosja V, faqe 92, faqe 110, faqe 117 dhe faqe 140
- Pasaporta e vulosur e Moshe Harel – Dosja V, faqe 165
- Informata nga Turkish airlines – Dosja VI, faqe 427
- Informata lidhur me tatimet – Dosja VII, faqe 867
- Informata mbi regjistrim të veturës– Dosja VII, faqe 921
- Informata kadastrale – Dosja VIII, faqe 1045
- Informata lidhur me aktivitete të llogarive bankare të Moshe Harel – Dosja VIII, faqe 1092 deri 1094 dhe dosja XI, faqe 648 deri 856
- Deklarata e MS më 9 nëntor 2008 – Dosja VIII, faqe 1107
- Deklarata e YA më 5 nëntor 2008 – Dosja VIII, faqe 1113
- Deklarata e IA më 4 nëntor 2008 - Dosja VIII, faqe 1119 dhe Dosja XIII, faqe 285
- Lista e personave të ftuar /të garantuarve /nga Klinika Medicus - Dosja VIII, faqe 1122
- Intervistimi me RF dhe RF nëpërmjet Asistencës Ligjore Ndërkombëtare në Kanada – Dosja X, faqe 493 dhe XXII, faqe 957
- Deklarata e TB - Dosja XII, faqe 1
- Deklarata e BG - Dosja XII, faqe 22
- Deklarata e SM - Dosja XII, faqe 165
- Deklarata e EP - Dosja XII, faqe 203
- Deklarata e NS – Dosja XII, faqe 228
- Deklarata e BS më 8 nëntor 2008 – Dosja XII, faqe 228
- Deklarata e ES më 10 nëntor 2008 - Dosja XII, faqe 246
- Deklarata e MS më 9 nëntor 2008 - Dosja XII, faqe 260
- Deklarata e AA - Dosja XIII, faqe 282
- Deklarata e YA më 5 nëntor 2008 - Dosja XIII, faqe 289
- Deklarata e YA më 8 nëntor 2008 - Dosja XIII, faqe 300
- Deklarata e YA më 11 nëntor 2008 - Dosja XIII, faqe 308
- Deklarata e Islam Bytyqi - Dosja XIII, faqe 317
- Deklarata e Sylejman Dulla më 23 qershor 2008 dhe 8 korrik 2008 - Dosja XIII, faqe 368 dhe 421
- Deklarata e MH - Dosja XIII, faqe 454
- Deklarata e Sokol Hajdini - Dosja XIII, faqe 459
- Deklarata e YA nën seancë të jashtëzakonshme hetimore - Dosja XIV, faqe 4
- Deklarata e Driton Jilta – Dosja XIII, faqe 122
- Deklarata e TP - DXIII, faqe 220
- Deklarata e TP - Dosja XIII, faqe 237
- Deklarata e ES - Dosja XIII, faqe 272

- Deklarata e MS - Dosja XIII, faqe 278
- Deklarata e MH - Dosja XIII, faqe 282
- Deklaratat e BS - Dosja XIII, pg. 298 dhe Dosja XIII, faqe 316
- Deklaratat e ES - Dosja XIII, faqe 336
- Deklaratat e Lufti Dervishi më 6 nëntor 2008 dhe 15 qershor 2010 - Dosja XIV, faqe 398 dhe dosja XIV, faqe 416
- Deklaratë me shkrim nga Lufti Dervishi - Dosja XIV, faqe 411
- Deklaratat e Sullejman Dulla më 18 tetor 2010 dhe 8 korrik 2010 - Dosja XIV, faqe 595
- Raporti i ekspertit lidhur me situatën financiare përfshirë edhe regjistrimin kadastral dhe të veturës – Dosjet XX e XXI
- Librat e klinikës dhe dokumente të tjera të konfiskuara gjatë bastisjes Dosja IV, faqe 6 deri 150);
- Fotografitë e bëra gjatë dhe pas bastisjes (Dosja V, faqe 80); Raporti i ekzaminimit të ekspertit mbi gjësendet e konfiskuara (Dosja V, faqe 140), datuar 20 janar 2009
- Shqyrtimi i provave: krahasimi i librit të protokollit si provë e konfiskuar (Dosja VII, faqe 647), datuar 9 korrik 09;
- Raportimi i ekspertizës për provat e konfiskuara gjatë bastisjes, datuar 9 qershor 09 dhe 4 gusht 10 (Dosja VIII, faqe 1086, 1140 dhe 1144)
- Rezultatet e analizës së të dhënave nga Klinikës Medikus, datuar 24 nëntor 2010 (Dosja provat pas aktakuzës, faqe 75 gjer 80)
- Provat e listuara si rezultat i konfiskimit gjatë bastisjes (Dosja provat pas aktakuzës, faqe 45)
- Fotografitë e bëra gjatë bastisjes (Dosjet A dhe B);

Analiza e provave të shënuara më lart lejon të arrijmë në përfundimin se ekziston dyshimi i bazuar se të paktën 20 operacione janë kryer në Klinikën Medikus gjatë periudhës së përmendur në aktakuzë; gjithashtu na lejon të përfundojmë se ekziston dyshimi i mirëbazuar se të paktën 2 prej tyre ishin transplantime të veshkëve të njerëzve (F/? dhe B/A, si marrës /dhënës). Është poashtu e pamohueshme se transplantimi i organeve të njerëzve – si aktivitet privat mjekësor – është i paligjshëm në Kosovë sipas ligjit në fuqi në kohën e rrjedhjes së ngjarjeve, sipas Pjesës 46, pika d) të ligjit të shëndetësisë në Kosovë 2004/4 nga 19 shkurt 2004. Sipas provave të njëjta, ekziston dyshimi i mirëbazuar se brenda periudhës së përmendur po kryhej një aktivitet i organizuar me qëllim të kryerjes së operacioneve përfshirë këtu edhe transplantimin e paligjshëm të veshkëve me *modus operandi* të njëjtë me ndërhyrjen e njerëzve të njëjtë (përfshirë edhe të dyshuarit kundër të cilëve nuk është ngritur aktakuzë), në mënyrë sistematike për dhënësit dhe marrësit e huaj dhe me përfshirjen e pagesave në shkëmbim.

Sidoqoftë, për një analizë të mëtejme të pikave të përmendura më lart të akuzës, ia vlen tani të ofrojmë një transkribim të veprës penale trafikim me njerëz, gjë për të cilën

akuzohen të pandehurit Lufti Dervishi, Arben Dervishi, Driton Jilta dhe Sokol Hajdini.  
Është kjo si në vijim:

### Neni 139 i KPK-së – trafikimi me njerëz

(1) Kushdo që merr pjesë në trafikimin e njerëzve dënohet me burgim prej dy deri në dymbëdhjetë vjet.

(3) Kushdo që organizon një grup personash për të kryer vepër nga paragrafi 1 i këtij neni

dënohet me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej shtatë deri në njëzet vjet.

(...)

(8) Për qëllime të nenit aktual (...)

1) Shprehja "trafikim me njerëzit" do të thotë rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.

2) Shprehja "shfrytëzim" ashtu siç është përdorur në pikën 1 të këtij paragrafi, përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.

3) Pëlqimi i viktimës së trafikimit me njerëz për qëllime shfrytëzimi nuk merret parasysh kur cilado prej mjeteve të parashtruara më lart në pikën 1 të këtij paragrafi është përdorur kundër viktimës së tillë.

Nga analiza e përmbajtjes së definicionit ligjor të trafikimit me njerëz – neni 139, paragrafi 8, nënparagrafi 1, elementet faktike për t'u verifikuar janë si në vijim:

- a) Rekrutimi, transportimi, strehimi dhe pranimi i personave,
- b) Nëpërmjet formave si në vijim:
  - i. kërcënimi
  - ii. përdorimi i forcës
  - iii. formave të tjera të shtrëngimit
  - iv. rrëmbimi
  - v. mashtrimi
  - vi. falsifikimit
  - vii. keqpërdorimi i pushtetit apo i një pozite të ndjeshme
  - viii. pranimi i pagesave apo përfitimeve për marrjen e pëlqimit të personit që ka kontroll mbi personin tjetër,
- c) për qëllime të shfrytëzimit (përfshirë heqjen e organeve sipas nenit 139, paragrafi 8, nënparagrafi 2, KPK).

Lidhur me rastin aktual, edhe pse rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi dhe pranimi i personave - (a – si dhe qëllimi i shfrytëzimit - c) – verifikohen edhe nga lista e lartpërmendur e provave e prezantuar nga prokuroria kur ka të bëjë me ndonjë nga mënyrat e shënuara më lart b) nuk ekziston asnjë linjë provash në asnjë nga 34 dosjet e lëndës (*rectius*, ekziston vetëm një fjali e vetme në një deklaratë të vetme të YA, së cilës do t'i referohemi më vonë dhe do ta analizojmë më poshtë).

Ç'është e vërteta, fare nuk janë mbledhur prova lidhur me mënyrën në të cilën janë kryer veprimet e tilla, pra: kërcënimet eventuale, përdorimi eventual i forcës, forma të tjera eventuale të shtrengimit, rrëmbimi eventual, mashtrimi eventual, falsifikimi eventual, keqpërdorimi eventual i pushtetit apo i pozitës së ndjeshme, apo arritja eventuale e pëlqimit të personit që ka kontroll mbi personin tjetër.

Duke iu referuar aktakuzës, është përmendur nën pikën 67 një listë prej 20 transplantimeve dhe nën pikën 58, *“viktimat janë rekrutuar për shkak të brishtësisë së tyre akute dhe nëpërmjet përdorimit të përpjekjeve detyruese të pagesave me të holla për të marrë pëlqimin për heqjen e organeve të tyre. Premtimi i rremë për pagesa me para veptori si nxitës i mëvetësishëm për marrjen e pëlqimit për heqjen e organeve për shkak të varfërisë së skajshme apo gjendjes së rëndë financiare të viktimave. Pra, viktimat ishin tejet të ndjeshme ndaj rekrutimit për qëllim të trafikimit me njerëz dhe shfrytëzimit nëpërmjet heqjes së organeve të tyre, në kundërshtim me nenet 139 (1) dhe (8), KPK.”*

Më tutje *“C. ANALIZA E PROKURORIT”* dikton: *“në mes të datës 1 janar 2008 dhe 4 nëntor 2008, më së paku 15 – 20 njerëz janë trafikuar në Kosovë për qëllim të heqjes së veshkëve të tyre në Klinikën MEDICUS. Këto viktima janë rekrutuar në shtete të tjera, pastaj janë transportuar dhe pranuar në Aeroportin e Prishtinës me premtimin e rremë për pagesë në shkëmbim të heqjes së veshkëve të tyre. Këta u “shfrytëzuan” sipas definicionit të paraparë në KPK ngase heqja e organeve vlerësohet si shfrytëzim nga ana e kodit. Pëlqimi i tyre për heqjen e organeve dhe udhëtimi në Kosovë për këtë qëllim nuk është relevant për shkak të shfrytëzimit, siç parashihet me nenin 139(8), KPK”.*

Tash me të marrë parasysh të gjitha provat, ia vlen të përmendet se përpos YA si dhënë dhe BS dhe RF si marrës, asnjë nga 20 viktimat e tjerë të shënuar, nuk janë gjetur pavarësisht nga të gjitha përpjekjet e kërkesave për asistencë ndërkombëtare ligjore.

Duke marrë parasysh rëndësinë e masës konkrete të përdorur nga kryerësi për të ardhur deri te përfundimi për një vepër penale efikase siç edhe definohet ligjërisht, ka fare pak gjasa të definohet dhe të vlerësohet se a ka pasur *“premtime mashtruese për pagesa me para të gatshme”* pa marrë në konsideratë deklaratat konkrete të ndërmjetësit të drejtpërdrejtë, duke detalizuar negociatat e tyre (apo prova të tjera të vlefshme, të cilat mund t'i zëvendësojnë arsyeshëm). *“Prova të ngjashme fakti”* siç u cek në faqe 13 të aktakuzës mund të konsiderohen si të mjaftueshme që dyshimi i bazuar të hetohet tutje, por asnjëherë për dyshim të mirëbazuar për të konfirmuar dënim të mundshëm të ndonjërit nga të pandehurit e akuzuar gjatë shqyrtimit kryesor.

Prandaj, në veçanti lidhur me këto viktime nuk janë mbedhur prova që sjellin deri te përfundimi, nën pikën 58 të aktakuzës se *“viktimat u rekrutuan për shkak të brishtësisë së tyre të theksuar dhe nëpërmjet përdorimit të ofertave shtrënguese me pagesa në para të gatshme për të marrë pëlqimin e tyre për heqjen e organeve të tyre. Premtimet mashtruese për pagesa me para të gatshme vepruan si nxitje e mëvetësishme për marrjen e pëlqimit për shkak të varfërisë së skajshme apo gjendjes së rëndë financiare të viktimave. Si të tillë, viktimat ishin tejet të ndjeshëm ndaj rekrutimit për qëllim të trafikimit me njerëz dhe shfrytëzimit nëpërmjet heqjes së organeve të tyre, në kundërshtim me nenet 139 (1) dhe (8), KPK.”* Ose që *“(…) të paktën 15 – 20 njerëz janë trafikuar në Kosovë me qëllim të heqjes së veshkëve të tyre në Klinikën MEDICUS. Këto viktime janë trafikuar në shtete të tjera, pastaj janë transportuar dhe pranuar në Aeroportin e Prishtinës me premtimin mashtrues për pagesë në shkëmbim me heqjen e veshkëve të tyre. Sipas definicionit të paraparë me KPK, këta u “shfrytëzuan” ngase heqja e organeve hyn brenda definicionit të shfrytëzimit.”*

Nëse ligji në mënyrë të qartë kërkon përdorimin e të paktën një ndër mënyrave të listuara në paragrafin 8 të nenit 139, KPK, nuk mund të lejohet si presupozim mjaft gjenerik apo përfundim si p.sh. *“premtimi mashtrues për pagesa me para të gatshme veprimi si nxitje e mëvetësishme për marrjen e pëlqimit të tyre për heqjen e organeve për shkak të varfërisë së skajshme apo gjendjes së rëndë financiare”* pa baza konkrete dhe individuale faktike dhe prova përkatëse. Përndryshe, këto mënyra nuk do të listoheshin dhe në vend të kësaj do të përdorej një dispozitë gjenerike. Sidoqoftë, prova lidhur me këtë element konkret ligjor në të gjitha dosjet e lëndës, thjeshtë nuk ekzistojnë.

Si prova relevante për këtë çështje specifike duhet të marrim në konsideratë deklaratat e dhëna nga YA si dhënësi i vetëm i gjetur, nga marrësit e gjetur BS dhe RF dhe anëtarëve të tyre të familjes, E dhe MS dhe RF. Edhe pse lidhur me këtë vepër penale, është e qartë se viktime konsiderohet personi nga i cili është marrë organi (dhe jo marrësi), detalet e tregtisë mund të jenë disi relevante dhe jo të përbuzshme për të definuar *modus operandi*, të paktën sa u përket këtyre dy rasteve.

Megjithatë, duke marrë parasysh të gjitha deklaratat e E, B, M, R apo R, nuk është e mundur të konkludojmë se çdo premtim në të holla nuk ishte përmbushur në mënyrë që të përfundojë me një premtim mashtrues ashtu si referohet në aktakuzë. Të gjithë anëtarët e familjes S i referohen të afërmit e tyre - MC dhe RN, të cilët kurrë nuk u intervistuan; që të dy F i referohen një pagese efektive që i është bërë Moshe Harel që korrespondon me një shërbim të ofruar në mënyrë efektive, përkundër mosdijenisë së tij për paligjshmërinë në Kosovë. Askush asnjëherë nuk e ka përmendë veten si viktimë të një premtimi mashtruese. Moshe Harel ka dhënë një deklaratë, me të cilën asnjë nga ato detaje të gjurmara nuk u vërtetuan. Të gjitha ato, në këtë mënyrë, ofruan prova të padobishme në lidhje me detajet e tregtisë me viktimat.

Sa i përket donatorit të vetëm që dha disa deklarata - YA - ai është i vetmi në këtë rast që mund të tregoj të gjitha detajet e tregtisë në të cilën ai ka qenë drejtpërdrejtë i përfshirë. Duke i marrë parasysh të gjitha ato - më 5 Nëntor 2008 (Dosja VIII, fq 113 dhe Dosja

XIII, fq 289) më 8 Nëntor 2008 (Dosja XIII, fq 300) dhe më 11 Nëntor 2008 Dosja XIII, fq 308) - një premtim në të holla prej 20.000 USD është bërë nga ana e një personi, Ismail, për qëllime të tregtimit të veshkës së tij. Megjithatë, YA deklaroi më 5 Nëntor 2008: "*Kam nevojë për para, kisha shumëborxhe dhe mendoja për një jetë më të mirë*" duke iu referuar arsyeve pse e pranoi propozimin. Megjithatë, ai kurrë nuk ka thënë se Ismail ishte në dijeni të këtyre mendimeve, arsyet ose gjendja e tij personale dhe financiare; ai kurrë nuk përmendi se Ismaili ka përdorë ndonjë presion apo mjetet të përmendura në Nenin 139, paragrafi 8 të KPK-së (e as që është marrë në pyetje lidhje me të ndonjëherë).

YA gjithashtu deklaroi se do i merrte paratë e tij posa të arrinte në aeroportin e Stambollit pas operacionit. Ai gjithashtu shtoi, "*Sepse më kapën policia dhe humba paratë që më ishin premtuar si dhe veshkën*". Nuk është e mundur në këtë mënyrë të konkludohet për një premtim mashtruese të papërmbyshur nga Ismail ose dikush tjetër.

Dhe në fund fjalia e vetme e përmendur më lart që mund të konsiderohet si provë me qëllim që të dëshmohet një mjet penal ashtu siç parashihet me Nenin 139, paragrafi 8 i KPK-së, siç pohohet nga YA gjatë seancës së jashtëzakonshme hetimore (Dosja XIV, fq. 4) qëndron si në vijim: "*Ismaili më tha se nuk ishte e ligjshme në Turqi, por ishte e ligjshme në Kosovë*".

Edhe pse kjo fjali e vetme mund të konsiderohet si një mjet për mashtrim, nuk mund të jetë mjaft relevante për disa arsye: 1) koncepti i "*veprimtarisë së paligjshme*" nuk është domosdo e ngjajshme me "*veprimtarinë kriminale*", kështu që nuk është i qartë kuptimi i një shprehjeje të tillë; 2) kjo është e vetmja deklaratë lidhur me këtë çështje, e cila nuk është konfirmuar nga ndonjë dëshmi tjetër - Ismaili nuk është identifikuar ose i paraqitur si provë për shqyrtimin kryesor gjyqësor - dhe ka mjaft gjasa që prova të tjera mbase nuk mund të konfirmojnë këtë deklaratë, e cila nuk u përsërit nga viktima, madje as një herë gjatë deklaratave të tij të tjera, duke marrë parasysh Nenin 157, paragrafi 3 KPPK-së; 3) Edhe pse "*Në marrjen e aktvendimit sipas këtij neni, gjyqtari nuk detyrohet me përcaktimin ligjor të veprës penale siç është përcaktuar nga prokurori në aktakuzë (...)*" - Neni 316, paragrafi 6 KPP-së – sidoqoftë ka detyrime nga faktet e përmendura në aktakuzë. Askund në aktakuzë nuk është një fakt i përmendur apo i pretenduar që mund të konsiderohet si mashtrim me qëllim që të plotësohen kërkesat e Nenit 139, paragrafi 8, nënparagrafi 1 i KPK-së. Në vend të kësaj, gjithmonë premtimeve mashtruese i referohet. Të gjitha dëshmitë e mbledhura nga gjurmimi i kryer nuk shtojnë asgjë të rëndësishme në lidhje me element ligjor në mungesë: ata mund të shtojnë dëshmi të tjera në lidhje me transplantimet, të cilat janë kryer, por në lidhje me element në mungesë asgjë e re nuk është sjellë.

Për shkak të gjitha arsyeve të lartpërmendura - dhe në veçanti për shkak se një aktivitet i paligjshëm nuk është domosdo njësoj si një veprë penale nëse nuk materializohet në të gjitha elementet e përcaktuara me ligj (v.g. një prej mënyrave të cekura në listë) - pasqyron mungesën e provave, është vendosur si në dispozitiv se niveli i dyshimit të bazuar në lidhje me pikën një të akuzës nuk është plotësuar, kështu që ajo do të hidhet poshtë.

Lidhur me pikat 2 dhe 3 të akuzës, Krimi i organizuar ishte akuzë e bazuar në Nenin 274,

paragrafët 1 dhe 3 të KPK-së përkatësisht në lidhje me Arben Dervishin, Driton Jiltan, Sokol Hajdinin dhe Lutfi Dervishin. Të dyja akuza i referohen në mënyrë specifike trafikimit të personave duke marrë pjesë në nxjerrjen e organeve për transplantim tek personat e tjerë për qëllime të shfrytëzimit (ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së veprës penale, ose duke organizuar, krijuar, mbikëqyrë, menagjuar apo drejtuar veprimtaritë e grupit të organizuar kriminal së bashku me Jusuf Sonmez dhe Moshe Harel, bashkë-konspiratprët e pa-akuzuar).

Duke pasur parasysh veprën penale të parashikuar me Nenin 274, paragrafët 1 dhe 3 KPK-së dhe të gjitha të sipër përmendura lidhur me mungesën e dyshimeve të bazuar se një vepër penale e Trafikimit të Personave është kryer, pasoja detyruese dhe logjike do të jetë zgjerimi i mungesës së njejtë të provave edhe për këtë vepër penale. Në veprën penale të Krimit të Organizuar siç është parashikuar me Nenin 274 të KPK-së, të paktën një krim i rëndë kërkohet të ekzistojë. Në mungesë të këtij krimi të rëndë - i akuzuari në aktakuzë – as niveli i nevojshëm i dyshimit të bazuar në lidhje me këtë vepër penale nuk është plotësuar, dhe në këtë mënyrë ai poashtu lirohet, pa e marrë tutje në shqyrtim të konsideruar si të nevojshëm.

## *2. Lidhur me Pikat 4 dhe 6 (sëbashku):*

Siç është njoftuar më lart, në lidhje me tani në mënyrë specifike pikën 6, në një procedurë të bashkuar, një padi tjetër - PPS Nr. 107/10 - tani duhet të konsiderohet në lidhje me një çështje të mëparshëm procedurale.

Në qoftë se në aktakuzën PPS Nr. 41/09 të ngritur më 15 Tetor 2010 një listë e detajuar e akteve është përshkruar mjaft, në lidhje me PPS Nr. 107/10 përmendet vetëm se "*të andehurit Sulejman Dulla dhe Islam Bytyqi ishin të përfshirë respektivisht në të paktën 17 dhe 21 raste të heqjes së organeve apo operacioneve të transplantimit në Medicus në 2008*" (Dosja XVII, fq. 732). Lista e detajuar e përmendur nuk mund të mirret parasysh në këtë aktakuzë të veçantë, sepse ajo nuk është pjesë e saj - megjithëse është urdhëruar procedimi i përbashkët - dhe kështu, aktet e pretenduara si vepra penale nuk janë përshkruar mjaft me saktësi, në mënyrë që t'ua lejojë të pandehurve një mbrojtje të duhur dhe efektive kundër akuzës.

Edhe pse nuk është i detyruar me ligj - Neni 316, paragrafi 6 i KPPK-së, Gjyqtari i konfirmimit detyrohet nga faktet dhe mënyra se si pretendohet nga prokuroria në aktakuzë. Edhe pse vlerësimi gjyqësor nëse faktet janë përshkruar mjaft me saktësi ose jo nuk është paraparë menjëherë pas mbajtjes së seancës për konfirmim, pasoja nuk mund të jetë thjeshtë hedhja poshtë e aktakuzës. Neni 306, paragrafi 2 i KPPK-së duhet të zbatohet në mënyrë aq analoge dhe kjo aktakuzë duhet të këthehet në prokurori me qëllim që faktet që të ndryshohen në përputhje me saktësi të mjaftueshme, brenda 3 ditëve. Duke marrë parasysh këtë, çështja e ngritur e parashkrimit ligjor mbi këtë pikë 6 duhet të vendoset një fazë të mëtejshme.

Sa i përket në veçanti pikës 4, në lidhje me të pandehurit Lutfi Dervishi, Sokol Hajdini dhe Driton Jilta, çështja e ngritur e kufizimit të mundshëm ligjor tani duhet të vlerësohet dhe vendosur siç duhet.

Tani ndjek veprën penale të përcaktuara me ligj:

Neni 221.1 Ushtrimi i Kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore

*(1) Kushdo që pa pasur kualifikimet profesionale apo autorizime ligjore kryen jashtë trajtimit mjekësor ose angazhohet në disa aktivitete të tjera mjekësore për të cilat kualifikime të veçanta janë të kërkuara nga ligji, dënohet me burgim deri në një vit.*

Sipas Nenit 90, paragrafi 1, nënparagrafi 6 i KPK-së, "Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret pas (...) kanë kaluar afatet kohore: dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me burgim deri në një vit (...) "

Lidhur me këtë vepër të veçantë penale, aktvendimi mbi zgjerimin e hetimeve është lëshuar më 7 Tetor 2010 (Dosja XVII, fq. 610), që do të thotë, prokuroria nuk ka filluar para 7 Tetorit 2010 në lidhje me veprën penale në fjalë. Gjyqtari i nënshkruari mendon se anjë zgjerim i hetimeve lidhur me veprat e tjera penale ose procedura e përbashkët lejon tejkalimin e rregullave të detyrueshme të parashkrimit, si një garanci absolute e mbrojtjes. Duke marrë parasysh këtë, të gjitha veprat penale nuk mund të mirren parasysh nëse janë kryer para datës 8 Tetor 2008.

Megjithatë, nuk është e qartë se çfarë duhet të konsiderohet si "kryerje e një vepre penale" nga ligji në fuqi. Nga ana tjetër, aktakuza është ngritur duke marrë parasysh të gjitha 30 ndërmarrje kirurgjike kryekëput si një vepër penale në bashkë-veprim, duke e konsideruar si një akuzë të vetme. Është e qartë se sipas Prokurorisë ushtrimi i paligjshëm i mjekësisë është kryer gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe duhet të konsiderohet si e përfunduar vetëm gjersa akti i fundit është kryer. Duke marrë parasysh faktin se kjo vepër penale në veçanti mbron shëndetin publik se sa të viktimave individuale, nuk mund të konsiderohet për momentin se një krim i vazhdueshëm nuk është kryer në përputhje me rrethanat, pa vlerësimin e provave, të cilat duhet të prezantohen në shqyrtimin gjyqësor, në veçanti "mens rea" e nevojshme. Duke marrë parasysh këtë, parashkrimi ligjor duhet të vlerësohet në një fazë të më vonshme.

Një tjetër çështje juridike e ngritur gjatë seancës për konfirmim duhet të vendoset tani: natyra e kësaj vepre penale dhe sfera juridike e mbrojtjes së saj. Është e qartë se Neni 221 i KPK-së e definon një vepër penale kundër shëndetit publik. Në anën tjetër, "pa pasur kualifikimet profesionale" është definuar si alternativë për "pa autorizim ligjor". Kjo domosdo do të thotë se prania e njërit prej këtyre elementëve mjafton për të përmbushur dispozitën dhe në këtë mënyrë, vepra penale mund të kryhet nga dikush që mund të jetë në posedim të kualifikimeve të veçanta profesionale, në qoftë se autorizimi ligjor është gjithashtu i nevojshëm, por që nuk është siguruar.

Duke marrë parasysh këtë, provat e paraqitura duhet të vlerësohen tani, në lidhje me Pikën 4. - Të pandehurit Lutfi Dervishi, Sokol Hajdini dhe Driton Jilta.

Të rëndësishme për këtë akuzë janë dëshmitë e dokumentuara brenda dosjes së rastit:

- Deklarata e YA nga 5 Nëntori - Dosja VIII, fq. 1113
- Deklaratë e IA – Dosja VIII, fq. 1119
- Deklarata e RF nëpërmjet Ndihmës Ndërkombëtare Ligjore nga Kanadaja - Dosja X, fq. 493
- Deklaratë e TB – Dosja XII, fq. 1
- Deklaratë e BG - Dosja XII, fq. 22
- Deklaratë e SM – Dosja XII, fq. 165
- Deklaratë e NS - Dosja XII, fq. 220
- Deklaratë e ES - Dosja XII, fq. 246
- Deklaratë e Islam Bytyqit - Dosja XIII, fq. 317
- Deklaratë e Suleiman Dullës– Dosja XIII, fq. 421
- Deklaratë e MH - Dosja XIII, fq. 454
- Deklaratat e RF dhe RF – Dosja XXII, fq. 957
- Deklaratë e Driton Jiltës- Dosja XIII, fq. 122
- Deklaratë e MS – Dosja XIII, fq. 278
- Deklaratën e Lutfi Dervishit - Dosja XIV, fq. 398
- Deklaratë me shkrim të Lutfi Dervishit - Dosja XIV, fq. 411
- Deklaratën e Lutfi Dervishit – Dosja XIV, fq. 416
- Raporti Policor - Dosja V, fq. 169
- Deklaratë e AK - Dosja XII, fq. 125
- Deklaratë e Ilir Rrecajt - Dosja XIV, fq. 613:
- Licencë për kardiologji e nënshkruar nga Ilir Rrecaj - Dosja I, fq. 126
- Raporti i klinikës Medicus të datës 4 Gusht 2008, të nënshkruar nga Lutfi Dervishi – Dosja Post-Aktakuzë, fq. 187
- Letër e datës 2 Qershor 2008, e nënshkruar nga Arben Dervishi - Dosja Post-Aktakuzë, Fq. 181;
- Letër e datës 21 Gusht 2008 - Dosja Post-aktakuzë, fq. 199.
- Librat e Klinika dhe dokumentet e tjera të sekuestruara gjatë bastisjes (Dosja IV, fq 6-50);
- Fotografitë e marra gjatë dhe pas bastisjes (Dosja V, fq 80);
- Raporti mbi ekspertizën e objekteve të sekuestruara (Dosja V, fq 140) të datës 20 Janar 2009.
- Shqyrtimi i provave: krahasimi i librit të protokollit si dëshmi e sekuestruar, e datës 9 Korrik 09; (Dosja VII, fq 647.)
- Raportimi mbi ekspertizën e dëshmisë se sekusetruar gjatë bastisjes, të datës 9 Qershor 09, dhe 4 Gusht 10 (Dosja VIII, fq 1086, 1140 dhe 1144)
- Rezultatet e analizës së të dhënave të klinikës Medicus, të datës 24 Nëntor 2010 (Dosja aktakuzë dëshmitë Post, fq 75-80)
- Dëshmitë e cekura në listë si rezultat i sekuestimeve gjatë bastisjes (Dosja Post-Aktakuzë dëshmitë, fq 45)

- Fotografitë e marra gjatë bastisjes (Dosjet A dhe B);

**Analiza e provave** të cekura në listë më lart çon në përfundim se është më shumë e mundshme që të gjithë të pandehurit e përmendur e kanë kryer veprën penale me të cilën ngarkohen se sa të mos e kenë kryer.

Gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është e logjikshme, e qartë dhe e plotë me dëshmi mbështetëse.

Sa i përket të pandehurit Lutfi Dervishi, YA e identifikon atë në sallën e operacionit (Dosja VIII, fq 1113.); IA i referohet disa operacioneve të kryera të paktën nga ai (Dosja VIII, fq 1119.); RF e përmendi atë si personi që e pajisë me fotografitë digjitale, të dhënat mjekësore, një raport mjekësor dhe një dokument nga Ministria e Shëndetësisë që lejon operacionin (Dosja X, fq 493.); BG i referohet 4 ose 3 rasteve të transplantimit të veshkëve brenda 2 muajve të fundit, si dhe për të rastin e BS (Dosja XII, faqet 32 dhe 36); SM e ceku atë si pothuajse gjithmonë i pranishëm në 20 deri 30 raste të transplantimeve të veshkëve, ku ajo ishte poashtu personalisht e pranishme, duke përfshirë edhe transplantin e kryer në BS (Dosja XII fq, 165); ES e mban në mend atë në klinikë përpara transplantimit (Dosja XII, fq 246); MH e përmendi atë si anëtar të ekipit mjekësor të operacioneve (Dosja XIII, fq 454); MS e përmendi atë si personi që e ka operuar BS (Dosja XIII, fq. 278). Ky i pandehur kishte ngritur disa dyshime në lidhje me atë se kush ishte kryer i ekipit gjatë këto transplantimeve, por kurrë nuk e mohoi se kishte marrë pjesë në to (Dosja XIV, fq. 398, Dosja XIV, fq. 411 dhe Dosja XIV, fq. 416). Kur ky i pandehur zgjidh mbrojtjen e tij në bindjen e tij të fortë se transplantimet e organeve njerëzore në Klinikën Medicus janë autorizuar nga Ministri i Shëndetësisë, në bazë të letër që kishte marrë nga Ilir Rrecaj, të datës 12 Maj 2008, mund të jetë në përputhje me faktin se ai i kishte informuar marrësit me përmbajtjen e kësaj letre. Megjithatë kjo nuk shpjegon pse më 4 Gusht 2008 raporti i Medicus drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe të nënshkruar nga ky i pandehur ende i referohet nevojës së autorizimit për operacione të tilla dhe nevoja që të pajiset me atë, siç është përmendur në përgjigjen e datës 21 Gusht 2008, të konfirmuar nga Ilir Rrecaj, procedura e mëtejme që të pajiset me atë. Si dhe ajo nuk është sqaruar në letrën e datës 2 Qershor 2008 nga Arben Dervishi, si menaxher i klinikës dhe ndryshimi i dokumentit të certifikimit në mes të spitalit të kardiologjisë dhe të urologjisë, për të cilët ai ishte shumë i vetëdijshëm, si çdokush tjetër, sipas deklaratës së AK (Dosja XII, fq. 125).

Sa i përket të pandehurve Sokol Hajdini dhe Driton Jilta, dëshmia lidhur me pjesëmarrjen e dy prej tyre në transplantimet mund të gjenden me lehtësi: për shembull, TK dhe NS përmendën Sokol Hajdinin si të punësuar në urologji dhe zakonisht të ketë qenë pjesë e ekipit mjekësor në operacione (Dosja XII, fq 1 dhe Dosja XII, fq 220, respektivisht); SM e përmend Sokol Hajdinin si anesteziolog dhe zakonisht përgjegjës për plotësimin e formularëve anesteziologjik (Dosja XII, fq 165); Islam Bytyqi ka deklaruar se ai kishte punuar nën udhëzimet e tij (Dosja XIII, fq 317); MH e përmend atë si anëtar të ekipit mjekësor të Lutfi Dervishit (Dosja XIII, fq 454). "Mens rea" e tij, si element subjektiv nga natyra mund të nxirret nga provat materiale që do të prodhohen në shqyrtimin kryesor gjyqësor. Për momentin, provat e prezentuara në lidhje me deklaratën e AK të

përmendur si më sipër mjafton për të përmbushur nivelin e dyshimit të bazuar madje lidhur me njohuritë e paligjshmërisë së transplantimeve në Kosovë.

Nga ana tjetër, SM e cekë Driton Jiltan si palë të pranishme gjatë operacioneve jo vetëm në rastin e BS (Dosja XII, fq 165); Islam Bytyqi e cekë atë kur arrijnë me Jusufin për transplantimin e B (Dosja XIII, fq 317) dhe Sulejman Dulla e cekë atë si të pranishëm gjatë transplantimit të njëjtë (Dosja XIII, fq. 421). Ky i pandehur nuk e mohon praninë e tij me rastin e atij transplantimi (Dosja XIII, fq. 122), por ai nuk i referohet transplantimeve të tjera, dhe nuk e jep asnjë version të arsyeshme për praninë e tij. Faktet që ai pretendon nuk mbështeten nga ndonjë element të dëshmive, madje as edhe në kuptim të zakonshëm, siç mund të shihet lehtë nga deklaratat e tij.

Kredibiliteti i fundit të provave të përmendura më lart do të varen nga disa faktorë që do të verifikohen në shqyrtimin gjyqësor. Deri më tani, mbrojtja nuk ka paraqitur ndonjë vijë të mbrojtjes të aftë për të këthejë fuqinë dëshmuese të të gjitha provave të paraqitura nga prokuroria. Të gjithë deklaratat e të pandehurit i përmbahen një vije të mbrojtjes materiale në bazë të provave që nuk janë paraqitur nga prokuroria dhe të pa pranueshme në këtë fazë procedurale.

Në të vërtetë nuk ka mospërputhje të konsiderueshme në detaje relevante në mes të deklaratave të dëshmitarëve të ballafaquar me të gjitha dëshmitë dokumentare të analizuara. Kështuqë, standardi i provës në këtë fazë të procedurës, në tërësi, provat e paraqitura mjaftojnë për të justifikuar ekzistencën e një dyshimi të bazuar se këta të pandehur kanë kryer veprën penale të Ushtrimit të paligjshëm të veprimtarisë mjekësore (neni 221, 1 paragrafi KPK-së), si në aktakuzë.

Sidoqoftë, në lidhje me standardin e provës në këtë fazë të procedimit, si dhe të dispozitës së Nenit 376 të KPPK-së, Gjykata vlerëson se kjo është një çështje për shqyrtimin kryesor gjyqësor.

### 3. Lidhur me Pikën 5:

I pandehuri Ilir Rrecaj është i akuzuar për shkak se, në mes të datës 1 Janar 2008 dhe 4 Nëntor 2008, Ilir Rrecaj ka kryer veprën penale të abuzimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit duke abuzuar pozitën e tij zyrtare, duke tejkalluar kufirin e autorizimit të tij ose moskryerjen e detyrës së tij zyrtare, si ish-Sekretar i Përhershëm në Ministrinë e Shëndetësisë, Republika e Kosovës, duke përfituar një shumë që tejkallon 5.000 €, në ose afër Prishtinës, Kosovë. Paragrafët 69., 70., 74., me gjobë, 75 (fq. 17), 86., 87. (Fq. 19) dhe "*Analiza e prokurorit*", (fq. 35) drejtëpërdrejtë i referohen të gjitha fakteve të nevojshme për një aktakuzë që të konsiderohet të përfunduar në masë të mjaftueshme në një mënyrë të detajuar. Poashtu është përfshirë edhe "*përfitimi material që e tejkallon shumën e 5000 €*", nën ndonjë nga këto paragrafe, megjithatë ajo shprehimisht është përmendur nën paragrafët 33 (Fq. 11) dhe 46 (Fq. 12). Përfundimi, akuza, faktet dhe emri i veprës penale janë mjaft të qarta për të lejuar një mbrojtje efektive, pra çdo kundërshtim në lidhje me këtë çështje duhet të hidhet poshtë si e pabazë.

Duke marrë parasysh këtë, prova duhet të analizohet.

Të rëndësishme për këtë akuzë janë dëshmitë e mëposhtme të dokumentuara në dosjen e çështjes:

- Raporti i policisë që i referohet shkëmbimit të shpeshtë të SMS-ave në mes të të pandehurit Lutfi Dervishi dhe Ilir Rrecaj - Dosja V, fq. 169;
- Informatë e shkruar nga HK, që vepronte si sekretar i përhershëm tek HoJ më 19 Gusht 09 - Dosja VII, fq. 747.
- Deklarata e AG – Dosja XII, fq. 69;
- Deklarata e ZK - Dosja XII, pg.92;
- Deklarata e AK – Dosja XII, fq. 125;
- Deklarata e dëshmitarit ekspert NH - Dosja XII, fq. 515;
- Shqyrtimi i të pandehurit Ilir Rrecaj më 6 Nëntor 2008 - Dosja XIV, fq. 608;
- Shqyrtimi i të pandehurit Ilir Rrecaj më 22 Qershor 2010 – Dosja XIV, fq. 613;
- Licencë për kardiologji, e datës 7 Maj 2008 - Dosja I, fq. 126;
- Letër e datës 12 Maj 2008 - Dosja, I fq. 132 dhe Dosja Post-aktakuzë, fq. 206;
- Letër e datës 2 Qershor 2008, nënshkruar nga Arben Dervishi - Dosja Post-aktakuzë, fq. 181;
- Raporti i klinikës Medicus e datës 4 Gusht 2008, të nënshkruar nga Lutfi Dervishi – Dosja Post-aktakuzë, fq. 187;
- Letër e datës 21 Gusht 2008 - Dosja Post-aktakuzë, fq. 199.

#### **Neni 339,3 KPK-së - Shpëdorim i pozitës zyrtare**

*(1) Personi zyrtar, i cili me qëllim të përfitimit material për vete apo ndonjë person tjetër osë një organizatë afariste ose për t'i shkaktuar dëm personit ose organizatës tjetër afariste, e shpërdor pozitën e tij zyrtare ose nuk e kryen detyrën zyrtare, do të dënohet deri në dy vjet burgim.*

*(2)(...)*

*(3) Nëse vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni rezulton me përfitim material që tejkalon shumën 5.000 euro, kryesi dënohet me burgim prej një deri në tetë vjet.*

Siç është përdorur në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), termi "*dyshim i bazuar*" i referohet sasisë dhe cilësisë së provave që ekzistojnë në një çështje të caktuar për të mbështetur një besim të arsyeshëm objektive apo "*dyshimin*", se një individ i caktuar ka kryer veprën/veprat penale për të cilat ky person ngarkohet. Shih, për shembull, Neni 316 (1), pika 4 të KPPK, që e informon Gjyqtarin e Konfirmimit se një aktakuzë do të hidhet poshtë nëse nuk ka "*prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale në aktakuzë.*"

*"Kodi nuk është shumë i qartë sa i përket standardit të "provës së mjaftueshme", të*

referuar në Nenin 316 paragrafi 1 pika 4 KPPPK. Interpretimi duhet të bazohet në rolin e Gjyqtarit të Konfirmim, i cili vendos pas përfundimit të hetimeve, por nuk duhet paragjykuar gjykimin e çështjeve që do të merren parasysh në shqyrtim kryesor gjyqësor (Neni 317 paragrafi 1i KPPPK). Kështuqë, standardi duhet të jetë dëshmi e tillë që - nëse pranohet - mund të çojë në një konkluzion se më e mundshme është se një vepër e veçantë është kryer se sa jo. Në këtë drejtim, provat e paraqitura nga prokuroria duhet të janë në gjendje të sugjerojë se të gjitha elementet e veprës penale kanë ndodhë", - GjSK, 25 Tetor 2004.

Analiza e provave të cekura në listë më lart të çon në përfundimin se është më e mundshme se i pandehuri Ilir Rrecaj e ka kryer veprën penale për të cilën ai ngarkohet. Ka prova të qarta se i pandehuri Ilir Rrecaj ka vepruar si person zyrtar, siç përcaktohet me Nenin 107, paragrafi 1, nën-paragrafi 1, në lidhje me nënparagrafin 16 të KPK-së. Duke pasë deklaratat e marrësit të të dy veshkëve dhe të afërmeve përkatës në kuadër të kësaj dosjeje në konsideratë, dhe gjithashtu duke iu referuar transferave bankare të Moshe Harel, poashtu të dokumentuara në kuadër të kësaj dosjeje, një përfitim material që e tejkalon shumë prej 5000 Euro duhet të konsiderohet si mirë e bazuar, kushdo që ka përfituar prej saj. RF deklaroi (Dosja X, fq. 500) se i pandehuri Lutfi Dervishi ka përdorë një dokument të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës për të demonstruar atë se një transplantim i veshkës do të ishte gjë e ligjshme në Kosovë. E gjithë kjo duhet të konsiderohet si e mjaftueshme për të treguar lidhjen midis letrës së datës 12 Maj 2008 të nënshkruar nga i pandehuri Ilir Rrecaj, operacionit që pasoi dhe pagesës së saj, që e tejkalon shumë prej 5000 Euro, si përfitim material të paligjshëm që buron nga një operacion i paligjshëm, pa marrë parasysh kush ka përfituar me të vërtetë prej saj. Poashtu mjaft është dokumentuar si dëshmi se një licencë për kryerjen e transplantimit të organeve asnjëherë nuk është aprovuar zyrtarisht sipas procedurave të rregullta. Megjithatë letra e datës 12 Maj 2008 është lëshuar nga i pandehuri Ilir Rrecaj pa asnjë rekomandim nga bordi (AG), e as që ka kaluar nëpër zyrën e Ministrisë, si dokument i paregjistruar, pa numër protokoll, por mban një vulë zyrtare, si procedurë shumë e pazakontë (AK) dhe madje e parregullt (NH). Të dy dëshmitarët nuk mund të shpjegojnë as arsyen e as procedurën e përdorur nga ky i pandehur.

Duke marrë parasysh titullin dhe përmbajtjen specifike të letrës së lartpërmendur, arsyeja alternative mbetet e pashpjegueshme - siç pretendohet nga i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës gjatë seancës së konfirmimit. Kjo letër është adresuar në mënyrë zyrtare (në emër të një bordi dhe vazhdimisht thekson "*ne kontrolloam, e miratuam, ju njoftojmë*"), gjë që është mohuar nga anëtarët e tjerë të bordit të njëjtë zyrtar dhe titulli i saj shprehimisht i referohet "*konfirmimit të miratimit të licencës për shërbime urologjike*". I pandehuri pretendon se fjala është për "*gabim teknik*" apo "*sugjerim dhe qartësim të procedurave*", si arsye për këtë letër. Megjithatë, sequenca, ndërlikueshmëria e veprimeve të ndërmarra, përdorimi abuziv i një vule zyrtare pa regjistrim e as pa kaluar përmes protokollit janë akte që tejkalojnë kufijtë e procedurës së rregullt që të konsiderohet si një gabim i thjeshtë teknik.

Shpjegimi u avansua gjatë seancës për konfirmim nga ky i pandehur, sipas të cilit "*kjo ishte një politikë e ministrit për të mos e ndërprerë iniciativën, jo për të hedhur poshtë nismën*" si një arsye për letrën e datës 12 Maj 2008, edhe pse e shoqëruar nga Përmbajtja

e letrave të datës 2 Qershor 2008, raportit të klinikës Medicus të datës 4 Gusht 2008, të nënshkruar nga Lutfi Dervishi dhe letra e datës 21 Gusht 2008 nuk mjaftojnë për të përmbysur arsyetimin e mësipërm. Në fakt, kjo letër e fundit, në mënyrë strikte, duke iu përmbajtur protokollit drejtëpërdrejtë, i referohet letrës së mëhershme të Arben Dervishit dhe raportit të Medikusit nga data 4 Gusht 2008 dhe tërësisht lë jashtë çdo kërkesë të mëparshme dhe posaçërisht letrën e pretenduar të datës 4 Maj 2008 si të gabuar. Nga ana tjetër, letra e datës 12 Maj nuk e sqaron apo sugjeron ndonjë gjë më tutje, përveç se licenca u miratua. Prandaj dyshimet për shpërdorim të pozitës zyrtare janë të bazuara.

Lidhur me qëllimin e brendshme për të përfituar nga personi tjetër në veçanti si "*dolus*" (*mens rea*), përtej qëllimit të përgjithshme subjektive, siç kërkohet me Nenin 339 të KPK-së, si dhe çdo qëllim tjetër, mund të nxirren vetëm nga faktet materiale përreth - si pjesa më intim nga natyra. Duke pasur parasysh se nuk ka shpjegim tjetër të arsyeshëm për këtë veprim konkret material, mënyra si është kryer dhe duke pasë parasysh raportin e policisë që i referohet shkëmbimit të shpeshtë të mesazheve telefonike SMS mes Lutfi Dervishit dhe këtij të pandehuri - Dosja V, fq. 169 – dyshimi i bazuar gjithashtu përfshin këtë element subjektiv të përcaktuara në këtë vepër penale.

Natyrisht ky dyshim i bazuar, do të verifikohet dhe vlerësohet në kuadër të shqyrtimit kryesor gjyqësor.

Kështuqë, lidhur me standardin e provës në këtë fazë të procedurës, në tërësinë e tyre, prova e paraqitur është e mjaftueshëm për të justifikuar ekzistencën e një dyshim të bazuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale të Shpërdorimit të Pozitës Zyrtare (Neni 339,3 i KPK-së).

Lidhur me të pandehurin Driton Jilta, nuk ka prova në dosjen e çështjes se "*nuk i ka raportuar autoriteteve përkatëse lidhur me një ndërhyrje kirurgjike të paligjshme si pjesë e detyrës së tij si mjek i OSBE-së*", siç shkruhet shprehimisht në aktakuzë (fq. 35), me përjashtim të deklaratës së tij të datës 6 dhe 7 Qershor 2010, kur është marrë në shqyrtim në cilësinë e të pandehurit. Ky element thelbësor i kësaj vepre penale - "*Mos Raportimi*" - nuk është konfirmuar nga ndonjë pjesë tjetër e provave. Poashtu detyra konkrete dhe autoriteti konkret, tek i cili veprimtaria e paligjshme do duhej të raportohet madje as që janë përmendur në aktakuzë. Nga njërën anë, duke pasur parasysh Nenin 157, paragrafin 2 të KPPK-së, niveli i dyshimit të bazuar në këtë element të veçantë nuk është e përmbushur, në anën tjetër, pasiguria në lidhje me përmbajtjen e detyrës së dështuar dhe mungesa e referimit të autoriteteve përkatëse në aktakuzë nuk e lejojnë një mbrojtje efektive kundër këtyre "*fakteve*", e paqartë dhe jo mjaft e saktë në përshkrimin e tyre, dhe në këtë mënyrë e papranueshme, sipas Nenit 305, paragrafi 1, nënparagrafi 4 i KPPK-së. Për shkak të arsyes së parë nga dy të përmendura më sipër, hedhja poshtë e akuzës kundër të pandehurit Driton Jilta do të jetë si pasojë.

Duke marrë parasysh të gjitha më sipër, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Sipas Nenit 432, paragrafi 2, si dhe Nenit 434, paragrafi 2 të KPPK-së, vendimi i tanishëm mund të sfidohet me një ankesë të veçantë tek kolegji prej

tre gjyqtarësh brenda dyzet e tetë orëve të marrjes së aktvendimit të njëjtë nga palët dhe personat të cilëve të drejtat u janë shkelur.

Palët do të marrin përbajtjen e këtij aktvendimi të përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe (i pandehuri Jilta) në mënyrë të rregullt.

Ky vendim është lëshuar në 29 faqe në gjuhën angleze.

**Prishtinë**  
**2 Mars 2011**

**Gjyqtari i Konfirmimit**  
**Vitor Hugo Pardal**